

20150732483

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Neni 1

Në Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 25/15), dispozita nga neni 2 me të cilën në nenin 14 ndryshohen paragrafët (2) dhe (3) nuk do të zbatohen në procedurat në lidhje me përkrahjen financiare nga Programi për përkrahje financiare në bujqësi për vitin 2015 dhe Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2015.

Të drejtë të shfrytëzimit të përkrahjes financiare në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni kanë edhe shfrytëzuesit të cilët deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji nuk i kanë përmbushur detyrimet financiare ndaj Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ndërmarrjes Publike për Ekonomizim me Kullota në bazë të shfrytëzimit të kullotave në pronësi shtetërore dhe ekonomive të ujërave dhe bashkësive ujore në bazë të kompensim të papaguar të ujit, e të cilët do të pajtohen me deklaratë të parashtruar të verifikuar te noteri se pajtohen që detyrimet e papërmbushura të shlyhen me përkrahjen e miratuar financiare në pajtim me Programin për përkrahje financiare në bujqësi për vitin 2015 dhe Programin për përkrahje financiare të zhvillimi rural për vitin 2015.

Mënyrën e shlyerjes nga paragrafi (2) të këtij neni e përcakton Qeveria me rregullën nga neni 47 paragrafi (6) i këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".